

URDHËR
Nr. 288, datë 14.10.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCE NË SU “SHEFQET NDRQI”, TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 29, të ligjit nr. 162, datë 20.12.2020, “Për prokurimin publik”; të VKM-së nr. 285 datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, nëndrejtorit ekonomik, z. Skënder Gjoni, për çështjet e mëposhtme:

1. Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, në emër të personit që do të përfaqësojë SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, në të gjitha shkallët e gjykit, duke përfshirë: kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesat për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykit të kësaj çështjeje, si dhe t’i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga nëndrejtori ekonomik, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike, me fonde buxhetore dhe të ardhurat dytësore, për SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

3. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

4. Të nënshkruajë komunikimet e SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht titullarit të institucionit.

5. Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga titullari i institucionit.

II. Këto kompetenca do të ushtrohen nga n/drejtori ekonomik menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimit të ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

IV. Ngarkohet z. Skënder Gjoni dhe të gjithë nëpunësit e SU “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Silvana Bala